



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received / Delivety	23 - 10 3	viti god. year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojra Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPOMSHK	6634	2023	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1145/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1145/2023 të datës 06.09.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë f.sh. Ilapqevë rr. "Ilirisë" p.nr. Komuna e Malishevës, kundër Masës Disiplinore "Vërejtje" me numër Nr.657/2023 të datës 22.08.2023 të shqiptuar nga Udhëheqësja e Divizionit dhe Koordinimit, në çështjen juridike "Masë Disiplinore-Vërejtje", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1145/2023 e datës 06.09.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. **Anulohet** masa disiplinore "Vërejtja" me numër Nr.657/2023 e datës 22.08.2023 e shqiptuar nga Udhëheqësja e Divizionit dhe Koordinimit në Rajonin e Gjakovës ndaj ankuesit.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr vendimin me numër A.nr.851/2023 me datë 31.07.2023 me numër protokollit 5458/2023 me të cilin ka shfuqizuar masën disiplinore "Vërejtje" me numër Nr.379/2023 e datës 18.05.2023 e shqiptuar nga Udhëheqësja e Divizionit dhe Koordinimit të Inspektoratit Punës në Rajonin e Gjakovës ndaj ankuesit, dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë i cili e ka nxjerrë aktin e kontestuar administrativ dhe ka obliguar Udhëheqësen e Divizionit dhe Koordinimit në Rajonin e Gjakovës në kuadër të Inspektoratit të Punës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij

vendimi, të bëjë rivlerësimin e shkeljeve të pretenduara disiplinore të ankuesit dhe të veproj në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

Me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.851/2023 të datës 31.07.2023, Udhëheqësja e Divizionit dhe Koordinimit në Rajonin e Gjakovës ka nxjerr Vendim me Nr.657/2023 me datë 22.08.2023 me të cilin ankuesit i ka lënë në fuqi masën Disiplinore "Vërejtje" me numër Nr.379/2023 e datës 18.05.2023 e shqiptuar ndaj Inspektorit të Punës [REDAKTUAR]

Ankuesi [REDAKTUAR], i punësuar në Inspektoratin e Punës, më datë 06.09.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5962/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.657/2023 të datës 22.08.2023 të Udhëheqëses së Divizionit dhe Koordinimit në Rajonin e Gjakovës për shkak të vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike, diskriminimit dhe për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4770/2023 të datës 15.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendim masa disiplinore vërejtje me numër Nr.379/2023 i datës 18.05.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 29.06.2023; E-mail nga C.Z. për F.K. i datës 29.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 10.07.2023; Akt Emërim i N.A. me numër protokollit 263/22 i datës 02.09.2023; Përshkrimi i detyrave të punës me numër protokollit 174/22 i datës 27.06.2022; Vendim i Inspektoratit të Punës me numër Nr.1235/2022 i datës 06.12.2022; Ankesë kundër vendimit të komisionit të ankesave të KRU Gjakova Sh.A. me numër protokollit 092/2022 i datës 18.11.2022; Raport zyrtar me numër Nr.1213/2022 i datës 29.11.2022; Njoftim nga KRU Gjakova me numër protokollit 3035 i datës 14.12.2022; Vendim për anulimin e konkursit nga KRU Gjakova me numër protokollit 3034 i datës 14.12.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i N.A. i datës 02.02.2023; Publikimi në ëeb faqe i Aktgjykimit Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr.KO-27/21 i datës 16.12.2022; E-mail nga Gj.Q. për D.B. etj. i datës 20.03.2023; E-mail nga H.N. për A.D. etj. i datës 19.08.2022; E-mail M.V. për Gj.Q. i datës 10.05.2023; E-mail nga Gj.Q. për M.V. i datës 20.04.2023; Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës me numër Nr.KO-27/21 i datës 16.12.2022; Ankesën me numër të protokollit 5962/2023 të datës 06.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mail nga N.A. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 05.09.2023; Vendim masa disiplinore vërejtje me numër Nr.657/2023 i datës 22.08.2023; Raport zyrtar me numër Nr.1213/2022 i datës 29.11.2022; Vendim i Inspektoratit të Punës me numër Nr.1235/2022 i datës 06.12.2022; Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës me numër Nr.KO-27/21 i datës 16.12.2022; Njoftim për zbatim të vendimit A.nr.851/2023 i datës 31.07.2023; me numër protokollit 8174 i datës 07.09.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët duke konstatuar kompetencën lëndore të KPMSHCK-së, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR], është e bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit ka trajtuar pretendimin e ankuesit se masa disiplinore Vërejtje me shkrim është e pa bazuar në ligjin për Zyrtarët Publikë dhe pas analizimit të gjitha provave të bashkëngjitura në procedurë ka ardhur në përfundim se pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Ankuesi në cilën e Inspektoratit të Punës me datë 29.11.2022 ka hartuar “Raportin Zyrtar” në Kompaninë Rajonale të Ujësjetllësit GJAKOVA SH.A, raporti në fjalë është i nënshkruar nga dy Inspektor të Punës, ndërsa ankuesi me datë 06.12.2022 me Nr.1235/2022 ka nxjerr Vendim me të cilin ka anuluar një konkurs në ndërmarrjen e lartcekur. Kolegji duke marrë parasysh këtë çështje ka analizuar praktikën vendimmarrëse në Trupën Ekzekutive të Inspektoratit të Punës se ky institucion ka anuluar procedura të rekrutimit deri më datë 16.12.2022 kur është publikuar Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nr.KO27/21.

Meqenëse neni 94 i Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ka pasur vështirësi për implementim si në praktik por edhe në procedura gjyqësore, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me datë 05.02.2021 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit të lartshënuar, ndërlidhur me këtë që u theksua, Gjykata Supreme ka pasur dilema në kompetencat e Inspektoratit të Punës lidhur me anulimin e konkurseve sipas nenit 94 te ligjit të lartshënuar.

Gjykata Kushtetuese ka pranuar kërkesën për shqyrtim dhe ka nxjerr Aktgjykim nr.KO27/21 të cilin e ka publikuar me datë 16.12.2023, ka konstatuar se Inspektorati i Punës nuk mund të përvetësoj kompetenca gjyqësore, prandaj nisur nga Kushtetuta e Kosovës që aktgjykimet e Gjykatës kushtetuese janë obligative për të gjitha institucionet, si rrjedhojë e kësaj pas publikimit të këtij aktgjykimi Inspektorati i Punës nuk ka kompetencë të anuloj konkurse.

Nisur ngase u tha më lartë qëndron pretendimi i ankuesit, sepse ankuesi ka nxjerr vendim me datë 06.12.2022 me Nr.1235/2022 sipas praktikave të Inspektoratit të Punës me të cilin vendim ka anuluar një konkurs në Kompaninë Rajonale të Ujësjetllësit GJAKOVA SH.A, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese është publikuar me datë 16.12.2022 dhe ndërlidhur me këtë Udhëheqësja e Divizionit dhe Koordinimit të Inspektoratit Punës në Rajonin e Gjakovës me datë 18.05.2023 i ka shqiptuar “Vërejtje” me numër Nr.379/2023 ankuesit lidhur me mos zbatimin e Aktgjykimit nr.KO27/21 të Gjykatës Kushtetuese.

Ankuesi sipas lartpërshkrimit ka marr vendim me datë 06.12.2022 ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese është publikuar me datë 16.12.2022, prandaj ankuesi nuk ka mundur të zbatoj një aktgjykim i cili ende nuk është publikuar dhe si rrjedhojë nuk ka ndërlidhje në mes vendimit dhe pasojës nëse është shkaktuar, sepse praktika e Inspektoratit të Punës ka qenë që kanë anuluar konkurse para se të publikohet aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Kushtetuese.

Prandaj pretendimi i ankuesit është i qëndrueshëm dhe masa disiplinore është në kundërshtim me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-11 për Zyrtarët Publik (që ka qenë në fuqi), me të cilin është përcaktuar se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”.*

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1145/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Kryeinspektorit në Inspektoratin e Punës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.